

VENDIM
Nr. 58/2026

**PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË
NË FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT (AKSH) PËR VLERËSIMIN E SIGURISË KIBERNETIKE
DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË QYTETARËVE PËR SIGURINË
KOMBËTARE DHE DETYRIMET E SHQIPËRISË SI VEND ANËTAR I NATO-s”**

Në mbështetje të neneve 77, pika 2, dhe 78 të Kushtetutës, neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe neneve 25 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të 1/4 së deputetëve të Kuvendit, anëtarë të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe Partisë së Lirisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH) për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 9.4.2026.